



## **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

### **Përmbledhje**

#### **Takimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave**

**Datë: 17 Qershor 2025**

**Koha: 09:00-14:00**

Me 17 Qershor 2025 u mbajt takimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP). Takimi u drejtua nga Kryesuesi i Këshillit z. Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Përveç anëtarësisë së zgjeruar të KKP-së, drejtuesve të bankave dhe institucioneve financiare jo-bankare, në këtë takim morën pjesë edhe Guvernatori i Bankës Qendrore z. Ahmet Ismaili dhe Ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve z. Hekuran Murati, të cilët mbajtën fjalë përshëndetëse në hyrje të takimit. Gjithashtu, në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore (WB) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), përfaqësues nga Ambasada Amerikane, zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike i Zvicrës (SECO), si dhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia për Shoqëritë e Informacionit (ASHI), Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare (AMIK), Këshilli i Investitorëve Evropian (EIC).

Takimi u hap nga Kryesuesi i KKP-së z. Fusha, i cili në fjalën e tij hyrëse falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, duke vlerësuar veçanërisht përfshirjen e zgjeruar të përfaqësuesve në nivel drejtues nga institucionet anëtare dhe institucionet tjera relevante, përfshirë ato ndërkombëtare. Ai theksoi rëndësinë e këtij forumi si organ këshillues për Bankën Qendrore dhe të gjitha institucionet përkatëse, me synim forcimin e bashkëpunimit në drejtim të zhvillimeve të reja në sistemin e pagesave, standardizimit dhe garantimit të sigurisë së shërbimeve financiare. Z. Fusha theksoi se ky takim po zhvillohet në një moment kyç të reformave në kuadrin ligjor dhe infrastrukturën teknike, të cilat janë të ndërlidhura ngushtë me objektivat strategjike për integrim në sistemet e pagesave të Bashkimit Evropian dhe të rajonit. Në këtë kontekst, ai veçoi rëndësinë e dy projekteve madhore: anëtarësimi në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA) dhe zhvillimi i sistemit të pagesave të shpejta, të cilat përfaqësojnë hapa vendimtarë drejt modernizimit të mëtejshëm të tregut të pagesave në Kosovë.

Në vazhdim, Kryesuesi z. Fusha i dha fjalën Guvernatorit të Bankës Qendrore z. Ahmet Ismaili, për një fjalim rasti dhe përshëndetje për të pranishmit. Në fjalën e tij, Guvernatori Ismaili theksoi hapat strategjikë të ndërmarrë nga BQK drejt modernizimit të sistemit të pagesave dhe integritit të plotë në tregun evropian, në përputhje me Planin Strategjik institucional të BQK-së. Ai nënvizoi se ky proces përfaqëson jo vetëm një reformë teknike, por një transformim të thellë strukturor që përkon me vizionin për integrimin evropian dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë.

Në këtë kontekst, Guvernatori prezantoi arritjet konkrete në fushën legjislativë dhe rregullative, përfshirë miratimin e tre ligjeve thelbësore: Ligji për Bankat, Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Amandamentimet e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të cilat u shoqëruan nga një paketë prej mbi 20 rregulloresh të reja që sigurojnë përputhshmëri me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së.

Ai vuri në pah se procesi i para-aplikimit për anëtarësim në SEPA është përmbyllur në dhjetor 2024, dhe se BQK ka intensifikuar angazhimet në nivel rajonal dhe evropian për të siguruar përgatitjen e duhur të sektorit financiar për qasje në skemat SEPA. Pavarësisht përparimit të vlerësuar nga partnerët ndërkombëtarë, përfundimi i vlerësimit nga Komisioni Evropian është shtyrë për shkak të procedurave në shqyrtim kushtetues të ligjeve të reja. BQK mbetet e përkushtuar dhe pret përmbylljen pozitive të këtij procesi në një afat të afërt.

Guvernatori Ismaili, në vijim të fjalës së tij, theksoi se sipas vlerësimeve aktuale, anëtarësimi në SEPA pritet të sjellë përfitime ekonomike vjetore mbi 55 milionë euro, në dobi të qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës. Këto përfitime burojnë nga ulja e kostove të transfereve ndërkufitare, rritja e efikasitetit të pagesave, si dhe përmirësimi i kushteve të operimit për eksportuesit dhe sektorin privat në tërësi. Ai potencoi se ky zhvillim do të krijojë një ambient më të favorshëm për investime, do të lehtësojë qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe do të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë së Kosovës.

Në përputhje me këtë vizion strategjik, Guvernatori Ismaili theksoi se BQK është e përkushtuar në ndërtimin e një sistemi modern për pagesa të shpejta, të njohur si “TIPS Clone”, i cili përfaqëson një komponentë thelbësore të ekosistemit të avancuar të pagesave. Në këtë drejtim, ai njoftoi se është nënshkruar një Letër Qëllimi me Bankën e Italisë, si menaxhuese e sistemit TIPS të Eurosistemit, së bashku me tri banka qendrore të rajonit, për të zhvilluar një zgjidhje të përbashkët për pagesa të shpejta.

Guvernatori e cilësoi këtë si një arritje historike, duke theksuar se angazhimi i Bankës së Italisë në ndërtimin e sistemit tonë të pagesave përbën një dëshmi të besueshmërisë dhe pjekurisë institucionale të BQK-së, si dhe një hap të rëndësishëm drejt integritetit të plotë në infrastrukturën panevropiane të pagesave.

Ndër të tjera, Guvernatori Ismaili përmendi zbatimin e standardit IBAN për të gjitha institucionet jo-bankare, si dhe miratimin e udhëzuesit për standardizimin e QR kodeve, si dhe integrimin e Regjistrimit të Llogarive dhe atë të Kredive me platformën qeveritare e-Kosova në bashkëpunim me ASHI-në, përfshirë marrëveshjen me Fondin e Kursimeve Pensionale për lidhjen e sistemeve dhe mundësimin e validimit të llogarive. Njëkohësisht, njoftoi se BQK po punon për mundësimin e qasjes edhe në platformat globale të pagesave digjitale, si Apple Pay dhe PayPal, pas ofrimit të shërbimeve nga Google pay së fundi, me qëllim të zgjerimit të alternativave për pagesat moderne dhe të sigurta për qytetarët e Kosovës.

Tutje, Guvernatori z. Ismaili theksoi se një ndër sfidat më të mëdha janë përshtatja e sistemeve teknologjike të bankave dhe institucioneve jo-bankare me standardet e reja, garantimi i sigurisë kibernetike dhe përputhshmëria me kërkesat për autentifikim të fortë të klientëve, ngritja e vetëdijes publike për përfitimet e shërbimeve digjitale, si dhe përfshirja më e madhe e grupeve të ndjeshme dhe zonave rurale në këtë proces.

Në këtë kontekst, BQK pret nga sektori financiar që të investojë në teknologji dhe kapacitete njerëzore, të bashkëpunojë ngushtë me BQK gjatë fazave të testimit dhe zbatimit, të zgjerojë gamën e produkteve digjitale dhe të sigurojë qasje gjithëpërfshirës në këto shërbime, si dhe të kontribuojë në edukimin financiar të klientëve të tyre.

Guvernatori z. Ismaili nënvizoj mbështetjen nga partnerët ndërkombëtarë, si IFC dhe Banka Botërore. Bashkëpunimi me IFC-në është në funksion të mbështetjes për promovimin e bankingut të hapur, sandbox-ve rregullatore dhe mbështetjes nga BQK në ndërtimin e qendrave të inovacionit digjital. Ndërkohë, partneriteti me Bankën Botërore ka kontribuar në modernizimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe ndihmës në vijim për avancimin e infrastrukturës teknike, për të cilën jemi mirënjohës dhe falënderues.

Në përmbyllje, të fjalimit të tij, Guvernatori Ismaili theksoi se transformimi i sistemit të pagesave dhe digjitalizimi i shërbimeve financiare nuk është vetëm një detyrë institucionale, por një përpjekje e përbashkët që kërkon vizion, angazhim dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve të përfshira. Vetëm përmes këtij bashkëpunimi do të mundësojmë ndërtimin e një infrastrukture moderne, gjithëpërfshirëse dhe të sigurt, e cila i shërben zhvillimit ekonomik të vendit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Pas fjalimit të Guvernatorit, Kryesuesi i takimit z. Dardan Fusha i dha fjalën Ministrin në detyrë të Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, i cili u ndal në çështjen e digjitalizimit të pagesave dhe përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për të ofruar zgjidhje sa më efikase në këtë drejtim, përmes adaptimit të teknologjive të avancuara dhe shtrirjes së pagesave elektronike në të gjitha nivelet e shërbimeve publike.

Z. Murati theksoi se Kosova tashmë është në një fazë të re, në të cilën transformimi digjital është bërë domosdoshmëri dhe realitet global. Ai vuri në dukje avantazhet e shumta që sjell digjitalizimi krahasuar me përdorimin e parasë fizike, duke përfshirë reduktimin e kostove të prodhimit, transportit dhe zëvendësimit të kartëmonedhave të dëmtuara, si dhe adresimin e rrezikut të paraqitjes së parasë së falsifikuar, e cila përbën një barrë të rëndë financiare si për qytetarët ashtu edhe për bizneset.

Në këtë kontekst, Ministri nënvizoi se formalizimi i ekonomisë përmes pagesave digjitale luan një rol kyç në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të aktiviteteve të jashtëligjshme, duke rritur gjurmueshmërinë dhe transparencën në qarkullimin e vlerës monetare.

Ai gjithashtu përmendi përkushtimin e Qeverisë në avancimin dhe digjitalizimin e shërbimeve publike, si rrugën e vetme përpara për një administratë më efikase dhe të përgjegjshme. Z. Murati theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë aktorët institucionalë, përfshirë Bankën Qendrore të Kosovës, si dhe rëndësinë e takimeve të tilla ndërinstitucionale, ku mund të identifikohen zgjidhje gjithëpërfshirëse që garantojnë mbulueshmëri të gjerë dhe kosto të ulëta për përdoruesit finalë.

Ai gjithashtu përmendi bashkëpunimin me Bankën Botërore në fushën e digjitalizimit të pagesave, ku një ndër komponentët kryesorë të projektit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit financiar është pikërisht komponenti i ndërlidhur me modernizimin e pagesave publike dhe private.

Në përmbyllje të fjalës së tij, Ministri në detyrë z. Murati theksoi se Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar dhe do të vazhdojë të mbështesë të gjitha iniciativat dhe institucionet që kontribuojnë në revolucionarizimin e sistemit të pagesave, në mënyrë që Kosova të ecë hap për hap me zhvillimet globale në këtë fushë jetike për ekonominë dhe shoqërinë.

Pas fjalimeve përshëndetëse, fjalën e mori Zëvendësguvernatori dhe Kryesuesi i Këshillit Kombëtar të Pagesave, z. Dardan Fusha, i cili në rolin e tij prezantoi në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe më hollësisht, zhvillimet më të fundit në fushën e pagesave, me theks të veçantë në avancimin e infrastrukturës ligjore dhe teknike, përgatitjet për integrim në sistemet evropiane, si dhe masat konkrete për modernizimin e tregut të pagesave në Kosovë.

Në fjalën e tij, z. Fusha theksoi se me mbështetjen kyçe të Bankës Botërore dhe në bashkëpunim të ngushtë me industrinë financiare, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe institucione të tjera relevante publike dhe private, janë finalizuar tri ligje themelore: Ligji për Shërbimet e Pagesave, Ligji për Bankat dhe amandamentimet e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ai u ndal në mënyrë të veçantë tek Ligji për Shërbimet e Pagesave, i cili, siç tha ai, transponon drejtpërdrejt direktivat dhe rregulloret kryesore të Bashkimit Evropian, të njohura si PSD2, EMD2, PAD dhe IFR. Përmes këtij ligji synohet avancimi i mbrojtjes së konsumatorit dhe forcimi i kërkesave për siguri përmes autentifikimit të thelluar të klientit, si dhe krijimi i hapësirës për rritjen e konkurrencës në tregun e pagesave përmes mundësimit të shërbimeve të reja të bazuara në teknologji të avancuara dhe shërbime nga distanca.

Z. Fusha theksoi se ky legjislacion do të mundësojë hyrjen e aktorëve të rinj në treg dhe ofrimin e shërbimeve të avancuara, si inicimi i pagesave dhe informimi mbi llogaritë e pagesave, duke hapur rrugën për implementimin e bankngut të hapur. Ky model, tha ai, mbështetet në ndërlidhjen e sigurt të sistemeve përmes autorizimit nga konsumatorët për përdorimin e të dhënave të llogarive të tyre nga palët e treta (institucione të licencuara të pagesave). Për të siguruar zbatimin efektiv të këtij ligji, BQK ka përgatitur një paketë prej 20 rregulloresh të reja, të cilat pritet të hyjnë në fuqi paralelisht me ligjin.

Në këtë kontekst, Zëvendësguvernatori prezantoi edhe propozimin për themelimin e një grupi punues ndërinstucional për zbatimin e bankngut të hapur, me pjesëmarrjen e institucioneve relevante publike dhe private. Ai theksoi se kjo qasje është e domosdoshme për të siguruar standardizimin teknik dhe ndërlidhjen funksionale ndërmjet sistemeve, duke adresuar nevojat e tregut për shërbime specifike të pagesave dhe duke garantuar përputhshmëri me kërkesat e ligjit të ri, si dhe sigurinë e duhur për integrimin e sistemeve.

Tutje, z. Fusha elaboroi procesin e përgatitjes së aplikacionit për anëtarësim në SEPA, duke theksuar se më 14 tetor 2024, BQK ka dorëzuar aplikacionin preliminar, ndërsa më 20 dhjetor ka plotësuar dokumentacionin me versionin final. Ai vlerësoi lartë mbështetjen e Bankës Botërore, si dhe të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare partnere, në këtë proces kompleks që ka kërkuar një koordinim të ngushtë ndërinstucional. Për këtë qëllim, gjatë vitit të kaluar janë mbajtur një sërë takimesh të përbashkëta me Thesarin, Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Administratën Tatimore, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencinë e Konkurrencës, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Agjencinë për Shoqëri të Informacionit dhe institucione të tjera të relevante.

Ai gjithashtu përmendi punëtorinë kushtuar SEPA-s, e organizuar me pjesëmarrjen e institucioneve financiare gjatë vitit të kaluar, e cila do të vazhdojë edhe këtë vit me fokus në aspektet ligjore dhe teknike të përgatitjes për aplikim në skemat SEPA. Në këtë punëtori, e mbështetur nga Banka Botërore, do të marrin pjesë ekspertë nga Këshilli Evropian i Pagesave, Banka Qendrore Evropiane dhe përfaqësues të bankave komerciale evropiane, me qëllim ofrimin e udhëzimeve të detajuara për hapat që duhet të ndërmarrin OSHP-të për aplikim në SEPA.

Z. Fusha ndau edhe disa nga sfidat me të cilat janë përballur vendet e rajonit që janë anëtarësuar tashmë në SEPA, përfshirë nevojën për identifikimin e partnerëve të duhur në BE për kliring dhe shlyerje në BE, si dhe domosdoshmërinë për rishikimin e tarifave për pagesat ndërkufitare në përputhje me mundësitë e reja që krijohen përmes SEPA.

Më tej, ai foli për projektin e ndërtimit të sistemit të pagesave të shpejta (“TIPS clone”), i cili është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore dhe që ka rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjes me Bankën e Italisë, si ofruer i këtij sistemi. Ai sqaroi se për funksionalitet të plotë të këtij sistemi, do të nevojiten edhe shërbime shtesë si: mundësimi i pagesave përmes kodeve QR, inicimit të kërkesës së pagesës (Request to Pay), identifikimi përmes një pseudonimi si numri i telefonit apo emaili (Proxy ID), dhe verifikimi i pranuesit të pagesës (Verification of Payee).

Në funksion të zbatimit të këtij projekti, z. Fusha tha se janë krijuar grupe punuese në nivele teknike dhe drejtuese nga Banka e Italisë dhe bankat qendrore të përfshira në këtë projekt nga rajoni, të cilat tashmë po takohen në baza të rregullta, me synimin që gjatë vitit të ardhshëm të fillojë operimi me shërbime të pagesave të shpejta në treg.

Në këtë drejtim, ai përmendi edhe përparimet në sistemin ekzistues KIPS, në operim që nga viti 2016, i cili po avancohet për të mundësuar ekzekutimin e transaksioneve në kohë reale, përfshirë opsionin e zgjatjes së orarit të operimit dhe mundësinë për kryerjen e transaksioneve edhe gjatë fundjavës, duke u afruar më tej drejt një modeli operativ 24/7. Plani për implementimin e Sistemit të pagesave të shpejta TIPS Clone është që të fillohet operimi i tij pas gjysmës së parë të 2026.

Zëvendësguvernatori, theksoi gjithashtu përkushtimin e BQK-së për forcimin e mbikëqyrjes së infrastrukturës financiare, ku ndër të tjera është themeluar Departamenti për Mbikëqyrjen e Tregjeve për të mbikëqyruar institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jo-bankare, institucionet e pagesave dhe institucionet për para elektronike. Në të njëjtën kohë, është në proces rishikimi edhe Politika për Mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave, për t’u adresuar zhvillimet më të fundit teknologjike sipas praktikave dhe standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Ai përmendi gjithashtu bashkëpunimin me IFC në fushën e digjitalizimit të shërbimeve financiare, përfshirë bankingun e hapur dhe përfshirjen financiare si objektive këto të përcaktuara edhe me Planin Strategjik të BQK-së 2024-2028.

Në përmbyllje të prezantimit, z. Fusha paraqiti disa statistika lidhur me Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël dhe theksoi se të gjitha këto zhvillime përfaqësojnë jo vetëm përparime të rëndësishme, por edhe sfida të konsiderueshme, të cilat mund të adresohen vetëm përmes një bashkëpunimi dhe koordinimi të ngushtë ndërmjet të gjithë akterëve të ekosistemit të pagesave në Kosovë, përfshirë sektorin publik dhe atë privat, si qëllim kryesor edhe i këtij forumi i cili po vazhdon me takimet e rregullta në adresimin e këtyre zhvillimeve.

Takimi vazhdoi me fjalimin e Z. Matija Laco, Menaxher i Projektit – Projekti i Modernizimit të Pagesave në Bankën Botërore.

Z. Laco, prezantoi mbështetjen e Bankës Botërore për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe projektet mbi SEPA-n dhe TIPS. Siç tha ai, ky diskutim në takimin e KKP-së shënon një hap të rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës drejt modernizimit të sistemit të pagesave. Ai theksoi punën e BQK-së, por edhe të aktorëve të tjerë të tregut dhe institucioneve qeveritare në këtë projekt modernizimi, por gjithashtu theksoi se puna kryesore mbetet sepse tani është pjesa e zbatimit e cila ndonjëherë është më e vështirë sesa pjesa rregullatore/legjislative.

Z. Laco, shtoi se mbështetja e Bankës Botërore për Kosovën filloi 10 vjet më parë me vlerësimin e hershëm mbi pagesat me vlerë të vogël, remitancat dhe edukimin financiar, e cila vazhdoi me SEPA-n. Ai deklaroi se BB mbështeti reformat jo vetëm në pjesën e brendshme, por edhe në lidhje me diskutimin tuaj me Brukselin dhe rajonin. Ai gjithashtu prezantoi tre projektet e Bankës Botërore mbi:

1. Projekti i Modernizimit të Pagesave të Ballkanit Perëndimor i mbështetur nga Bashkimi Evropian;
2. Programi i Remitancave dhe Pagesave i cili financohet nga SECO; dhe
3. Huadhëniet në Sektorin Financiar (që përfshinë komponentin e Pagesave të Shpejta);

Z. Laco, shpjegoi se aplikimi për SEPA është një proces kompleks midis Komisionit Evropian dhe vendit që aplikon për të marrë përgjigjen pozitive, dhe për anëtarësimin e Kosovës në SEPA, i cili hap akses në tregun e pagesave, dhe është i dobishëm për qytetarët, por edhe për bizneset që duan të zgjerohen. Ndërsa flasim për pagesat, flasim për njerëzit që në të vërtetë duhet të kryejnë transaksione për të blerë ose dërguar remitanca. Sistemet e pagesave kanë rëndësi vetëm nëse u shërbejnë njerëzve dhe bizneseve dhe nëse janë të sigurta, efikase dhe me çdo kusht të përballueshme, gjë që përkthehet në rëndësi ekonomike. Ai shtoi gjithashtu se është shumë e rëndësishme që Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave (OSHP-të) duhet të përshtatin infrastrukturën dhe të aplikojnë për skemën SEPA, gjë që nuk është një detyrë e lehtë për tu realizuar teknikisht dhe si proces, për t'i sjellë këto përfitime më afër vendit.

Z. Laco, theksoi se Banka Botërore është shumë e kënaqur që sheh që Kosova po prezanton sisteme të shpejta pagesash, pasi ato po ndryshojnë mënyrën se si lëvizin paratë dhe janë më transparente, të sigurta dhe më të shpejta.

Për më tepër, ajo që është e rëndësishme nga pikëpamja rregullatore/legjislative dhe infrastrukturore, është po aq e rëndësishme të investohet në edukimin financiar dhe njohuritë. Është shumë e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për përfitimet, sigurinë dhe përdorimin praktik që njerëzit dhe bizneset të ndihen të sigurt për të përdorur këto shërbime.

Në fund të fjalës së tij, ai tha se nga perspektiva e Bankës Botërore, ne jemi këtu për të ndihmuar dhe së bashku me BQK-në, nesër do të organizojmë një punëtori në lidhje me aspektet teknike dhe ligjore të lidhjes me skemën SEPA. Z. Laco mbylli fjalën duke përgëzuar punën heroike të BQK-së dhe institucioneve qeveritare për atë që kanë bërë drejt modernizimit të sistemit të pagesave.

Pas z. Laco, fjala ju dha për një prezantim z. Petrit Balijs, Drejtor Ekzekutiv në Shoqatën e Bankave të Kosovës, i cili tha se sektori bankar ka një rol të rëndësishëm në financimin e ekonomisë dhe ndërmjetësimin e pagesave, duke kontribuar në zhvillimin dhe stabilitetin e ekonomisë kombëtare. Në Kosovë, është arritur një përparim i dukshëm, me 73% të popullsisë që ka qasje në llogari bankare, një arritje e konsiderueshme për një ekonomi në zhvillim. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është implementimi i Procesit të SEPA, i cili është mbështetur nga bankat dhe do të kontribuon në rritjen e efikasitetit të pagesave për individët, bizneset dhe ekonomitë familjare.

Një nga sfidat kryesore që ka hasur sektori bankar ka qenë mungesa e mundësive për pagesa të shpejta. Sidoqoftë, këtë sfidë po e adreson Banka Qendrore e Kosovës, e cila ka për qëllim implementimin e pagesave të shpejta deri në vitin e ardhshëm.

Gjithashtu z. Balijs, tha se në fushën e sigurisë kibernetike, sektori bankar ka bërë përparime të mëdha, duke u anëtarësuar në platformën MISP të Luksemburgut, si dhe Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) po organizon fushata edukative për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me përdorimin e shërbimeve digjitale të bankave. Ky është një hap i rëndësishëm për të siguruar që klientët të jenë të informuar dhe të sigurt kur përdorin shërbimet digjitale të bankave.

Në fund të prezantimit z. Balijs, përmendi edhe disa çështje tjetra që po adresohen nga sektori bankar një ndër të cilat edhe regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave të klientëve ku po përpigemi ta bëjmë më të thjeshtë dhe digjital. Me ndihmën e Agjencisë për Regjistrimin Civil (ARC), po punojmë për zhvillimin e një modaliteti të ri për digjitalizimin e këtij procesi, duke lehtësuar qasjen dhe përmirësuar shërbimin ndaj klientëve dhe duke rritur efikasitetin e shërbimeve.

Pas z. Balijs fjala iu dha për një prezantim z. Visar Perani - Zyrtar Vendor i Korporatës Financiare Ndërkombëtare – (IFC) për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut për të prezantuar shkurtimisht projektin për Digjitalizim e Shërbimeve Financiare. Z. Perani, tha se takimi i sotëm është shumë i rëndësishëm për zhvillimet që po ndodhin sot në sektorin e pagesave. Ai shtoi se qasja në financa është një e drejtë themelore bazike për çdo qytetar.

Projekti për digjitalizim e shërbimeve financiare është projekt rajonal për Ballkanin Perëndimor, ku BQK ka qene institucioni i parë që nënshkroi marrëveshjen me IFC-në. Një ndër komponentët kryesore të këtij projekti që ia vlen me u përmend dhe ritheksua është bankngu i hapur. Nder të tjera, z. Perani tha se jemi në proces të themelimit të shoqatës së Fintech për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku si ide është forcimi i sistemeve të pagesave dhe mundësimi i inovacioneve të reja në këtë fushë. Në përmbyllje të prezantimit të tij ai falënderoj BQK-në për bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe punën e madhe që është duke realizuar në këtë fushë.

## **Pjesa e dytë:**

Pjesa e dytë filloj me prezantimin e z. Lumni Rustolli, në të cilin u prezantuan të dhënat mbi infrastrukturën e sistemit të pagesave, si dhe të dhënave statistikore mbi instrumentet dhe shërbimet e pagesave. Si pjesë të këtij prezantimi kishte edhe detaje dhe faktorë konkret që ndikojnë në rritjen e qasjes në shërbimet e pagesave elektronike.

Në këtë prezantim, fillimisht u paraqit funksionimi dhe roli i operimit me sistemin ndërbankar të pagesave KIPS, në përmbushjen e objektivit të BQK-së për të mbajtur një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Me këtë rast, ky sistem u vlerësua me nivel të lartë të stabilitetit në aspektin operacional, me një disponueshmëri të sistemit me mbi 99.9% dhe numër të vogël të pengesave, por gjithashtu me një stabilitet të nivelit të lartë edhe në aspektin e menaxhimit të likuiditetit.

U prezantuan gjithashtu, edhe të dhëna statistikore mbi numrin dhe vlerën e pagesave në sistemin e pagesave KIPS, nga ku u vlerësua se gjatë viti 2024 në KIPS janë procesuar 20.92 milion transaksione, me vlerë 25.38 miliard EUR, që është ekuivalente me rreth 2.5 herë e GDP-së, me një mesatare ditore: numri 83,690 dhe vlera 101,552,063.00 EUR.

Gjatë prezantimit u paraqiten të dhëna statistikore mbi përdorimin e terminaleve, si dhe transaksionet në ATM dhe POS, si dhe përdorimin e kartelave. Me këtë rast u vlerësua së gjatë vitit të fundit ka vazhduar trendi rritës i transaksioneve përmes POS terminaleve me një ngritje prej 43 përqind, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e pagesave jo cash. Sipas analizave të fundit, është vlerësuar se nga trendi i rritjes së pagesave jo cash për tri vitet e fundit, në vitin 2024 veç është arritur numri prej 48.14 i mesatares vjetore të transaksioneve jo cash për kokë banori, duke tejkaluar dukshëm objektivin prej 25 pagesa të parapara me Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (SKPVV) deri në vitin 2026.

Sa i përket numrit të llogarive dhe përfshirjes financiar, u vlerësua se në vitin 2024 ka pasur një rritje të numrit të llogarive, nga 2.55 milion në vitin 2023 në 2.62 milion në vitin 2024, nga të cilat rreth 390 mijë janë llogari me shërbime bazike.

Gjithashtu, në këtë aspekt u prezentua analiza mbi llogari-mbajtësit dhe bizneset e pajisuara me POS terminale. Me këtë rast nga të dhënat individuale që BQK ka mbledhur nga institucionet financiare, ka dalë se nga 1,21 milion qytetarë që janë mbi 16 vjeç, prej tyre 882,497 apo 73% posedojnë së paku një llogari të pagesave, me një raport gjinor rreth 46 për qind femra dhe 54 për qind meshkuj.

Gjithashtu, nga të dhënat që janë grumbulluar, sa i përket bizneseve, del se numri i përgjithshëm i bizneseve që kanë llogari financiare është 90,365. Nga të cilat, 6,234 biznese apo 6.7% janë të pajisura me POS terminale. Prej të cilëve 5,099 (81.8%) marrin shërbime vetëm nga një institucion financiar, ndërsa 1,135 biznese kanë llogari dhe përdorin POS nga dy ose më shumë banka/OSHP.

Pas z. Rrustolli, fjala iu dha z. Atdhetar Ibrahimimi, ku paraqiti veprimet e ndërmarra dhe sfidat e sektorit të ofruesve të shërbimeve të pagesave jo-banka. Ai në emër të IFJB-ve tha se jemi në një epoke ku teknologjia po ndryshon. Tutje, shtoj se janë mbi 10 institucione që ofrojnë shërbime të pagesave, roli i tyre është duke u rrit gradualisht dhe si pikë kryesore kemi ndikuar në rritjen e përfshirjes financiare tek personat fizik, reduktimin e përdorimit të parasë fizike dhe inovacionin. Në fund të prezantimit të tij tha se Ligji i ri për Shërbimet e Pagesave dhe nisma për bankingun e hapur janë hapa të mëdhenj përpara, megjithatë kërkohet mbështetje institucionale për të siguruar që të gjitha palët të kenë qasje të barabartë në të dhëna, përfshirë ato nga Regjistri Civil.

Pas prezantimit të z. Ibrahim, Kryesuesi z. Fusha, ia kaloi fjalën z. Jose M. Moreno de Barreda Specialist nga Korporata Financiare Ndërkombëtare – (IFC). Z. Barreda, i cili bëri një prezantim të detajuar për bankungun e hapur dhe hapat drejt realizimit të këtij projekti, duke paraqitur shembuj të suksesshëm nga vendet tjera, ku edhe shpjegoi rëndësinë e formimit të një grupi punues për bankungun e hapur, dhe avantazhet e organizimit të një grupi të tillë.

Ndër të tjera, Grupi i Punës do të bashkojë rregullatorët, bankat, kompanitë fintech, edhe institucionet tjera relevante publike dhe private, për një dialog privat-publik. Ai shtoi gjithashtu se ekziston nevoja për koordinim ndërinstitucional në fazën e hershme të zbatimit. Me zhvillimin e bankungut të hapur, ai tha se bankat nuk janë më aktorët e vetëm, por edhe institucionet e pagesave dhe Fintech-et duhet të luajnë një rol.

Në fund të prezantimit të tij, Z. Barreda, shpjegoi hapat e mëtejshme që duhet të ndërmerren për funksionalizimin e grupit punues, si dhe paraqiti afatin kohor se kur do të mund të fillohet me punën. Në fund, ai tha, le të zbatohet bankungun e hapur duke nxitur në mënyrë aktive inovacionin, duke shfrytëzuar raste reale të përdorimit (ang. Use cases) dhe duke siguruar gjithë përfshirjen. Tani nuk është koha për të pritur - është koha për të udhëhequr dhe formësuar zgjidhjet.

Me një fjalë rasti Kryetari i Bordit të BQK-së z. Bashkim Nurboja, tha se i inkurajoi të gjithë akterët me qenë shumë aktiv dhe të ketë një bashkëpunim sepse është shumë e rëndësishme për sistemin financiar në Kosovë me pas progres tek përfshirja dhe digjitalizimi i proceseve financiare. Gjithashtu, që të ketë edhe koncentrim tek pagesat e institucioneve qeveritare që të kryhen më lehtë në mënyrë digjitale, meqë ka volum të madh të pagesave duke inkurajuar Thesarin/MFPT dhe akterë të tjerë që kjo të realizohet brenda kornizave dhe pagesat të kryhen pa pengesa. Duke përfunduar, ai theksoi se është e rëndësishme që të ketë një iniciativë të tillë për të ofruar më shumë mundësi edhe për pranimin e pagesave elektronike.

Gjithashtu, gjatë vazhdimit të sesionit të dytë, fjalën e morën disa nga të pranishmit duke diskutuar mbi çështje të rëndësishme dhe duke dhënë sugjerime për pagesat me vlerë të vogël përmes POS edhe në institucionet publike, si dhe për rëndësinë e të dhënave statistikore sa i përket numrit të bizneseve që përdorin POS, duke ngritur nevojën e bashkëpunimit ndërinstitucional për nxjerrjen e këtyre të dhënave.

Pas diskutimeve z. Fusha vazhdoi me prezantimin e konkluzioneve dhe rekomandimet e dala nga ky takim, me fokus të veçantë themelimin e grupit punues për bankungun e hapur. Pas diskutimeve me mundësinë e kontributit dhe paraqitjes së qëndrimeve nga të gjithë të pranishmit, me që rast kishte një diskutim të rëndësishëm të çështjeve të ndryshme, z. Fusha vazhdoi me prezantimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të cilat ishin shpërndarë paraprakisht me anëtarët e KKP-së për shqyrtim dhe komentim, të paraqitura si në vazhdim:

## **1. Themelimi i Grupit Punues për Bankingun e Hapur**

Në përputhje me Nenin 6, paragrafi 1 i Udhëzimit për KKP-në, anëtarët e KKP-së miratuan:

- Termat e referencës për themelimin e Grupit Punues për Bankingun e Hapur;
- Planin e punës së këtij grupi.

## **2. Reduktimi i Parasë së Gatshme dhe Nxitja e Pagesave Elektronike**

BQK, në koordinim me Banka Botërore dhe anëtarët e Këshillit të vazhdoj aktivitetet e Grupit Punues për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe rritjen e pagesave elektronike.

## **3. Infrastruktura për sistemit të pagesave të shpejta (TIPS clone) dhe avancimi i funksioneve(upgrade) të KIPS-it:**

- Të vazhdon puna e grupit teknik për implementimin e Sistemit të Pagesave të Shpejta-TIPS clone, si dhe ngritjen e funksioneve(upgrade) në sistemin e KIPS-it.
- Pjesëmarrësit të përgatiten për përshtatjen teknike të tyre për TIPS-clone dhe KIPS-upgrade.
- BQK të koordinoj përzgjedhjen e ofruesit të shërbimit të rrjetit për TIPS-clone.
- Të analizohen opsionet për implementimin e funksioneve mbështetëse (overlay services), si QR code, Request to Pay, Proxy ID, Verification of Payee, etj.

## **4. Zbatimi i Ligjit për Shërbimet e Pagesave**

BQK të vazhdoj rishikimin dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për implementim të Ligjit për Shërbime të Pagesave.

## **5. Përgatitja për SEPA**

Të vazhdoj puna e grupit punues për përgatitjen e ofrueseve të shërbimeve të pagesave për aplikim në skemat e SEPA (CT, CT Inst, DD), si dhe përzgjedhjen e operatorëve për procesim të pagesave në SEPA.

## **6. Rishikimi i Tarifave për Pagesat Ndërkombëtare**

Në funksion të plotësimit të kriterëve për SEPA, Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave të fillojnë përgatitje për rishikimin e tarifave për transaksionet e pagesave ndërkombëtare.

## **7. Zbatimi i rregullores për IBAN nga Thesari/MFPT dhe IFJB-të**

Pas implementimit të rregullores së IBAN në 2024, të mundësohet shpërndarja e të gjitha llojeve të pagesave për klientët e IFJB-ve (shpenzime, paga, pensione dhe skemat e ndryshme sociale etj).

## **8. Edukimi Financiar i Përdoruesve**

Të vazhdojnë aktivitetet për organizimin dhe mbështetjen e kampanjave për edukimin financiar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përdorimin, përfitimet, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike.

## **9. Digjitalizimi e Pagesave për Shërbimet Publike**

Thesari/MFPT të përmirësojnë infrastrukturën që institucionet publike të mund të pranojnë pagesa për shërbimet përmes kartave dhe instrumenteve tjera elektronike (krahas shërbimeve në e-Kosova).

## **10. Qasja e IFJB-ve në Sistemin e Pagesave**

BQK të vazhdojë draftimin e akteve nënligjore për caktimin e kriterëve, komfor standardeve dhe praktikave në BE, që të mundësojnë qasjen e IFJB-ve në sistemin e pagesave.

## **11. Platformat Ndërkombëtare të Pagesave**

Të vazhdojnë angazhimet për përfshirjen e Kosovës në platformat ndërkombëtare të pagesave online, si: PayPal, Apple Pay, etj (pas përfshirjes së suksesshme në Google Pay);

## **12. Mundësimi i Verifikimit të Adresave dhe të Klientëve për KYC dhe SEPA**

Të mundësohet verifikimi i të dhënave të klientëve dhe adresave të tyre për bankat dhe IFJB-të në funksion të krijimit të lehtësirave për njohjen e klientit (KYC), si dhe verifikimin e të paguarit (Verification of Payee). OSHP-të (banka dhe IFJB) të angazhohen që brenda një periudhe sa më të shkurt të përmirësojnë të dhënat e klientëve, si: ID e klientit, adresat, statusi rezidencial dhe raportimin e tyre në Regjistrin e Llogarive.

## **13. Realizimi i Objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (SKPVV) KKP konstaton se janë arritur dhe tejkalar objektivat e Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlera të Vogla SKPVV (2021–2026), një vit para 2026 i përcaktuar si target:**

- Përfshirja financiare 73% e popullsisë së moshës madhore të ketë një llogari financiare, krahasuar objektivit prej 70% në 2026 nisur nga niveli prej 52% në vitin 2017.
- Rritja e numrit të pagesave jo cash në 49, kundrejt objektivit që të arrihej në 25 pagesa për kokë banori, deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare është marr nr.17 pagesa në vitin 2019.

## **14. Raportimi i Grupeve Punuese dhe Takimet e Ardhshme**

Anëtarët e KKP-së pajtohen që takimet e radhës të organizohen edhe më shpesh në rast të nevojës për përcjelljen e projekteve gjatë kësaj periudhe, bazuar edhe në raportimet nga grupet punuese për çështje që mund të kërkojnë mbështetjen e këshillit për mbështetjen e standardizimit dhe adaptimit të rregullave dhe infrastrukturës së nevojshme teknike.

**Pjesëmarrja në mbledhje.**

<b>Të ftuar në mbledhjen e KKP</b>		
<b>Institucioni</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozicioni</b>
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Ahmet Ismaili	Guvernator
<b>Ministria e Financave Punës dhe Transfereve</b>	Z. Hekuran Murati	Ministër në detyrë
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Bashkim Nurboja	Kryesues i Bordit të BQK-së
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Milot Cakaj	Zëvendësguvernator për mbikëqyrje financiare
<b>Ambasada e Zvicrës në Kosovë</b>	Znj. Arjeta Lleshi	Zyrtare e Lartë e Programit Kombëtar
<b>U.S Embassy</b>	Z. Craig Kim	Zyrtar per Ekonomi
<b>Banka Botërore</b>	Z. Matija Laco	Menaxher i projektit
<b>IFC</b>	Z. Visar Perani	Zyrtar vendor për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut
<b>IFC</b>	Jose M. Moreno De Barreda	Specialist

<b>Anëtarët e KKP</b>		
<b>Institucioni</b>	<b>Emri i Anëtarit</b>	<b>Statusi në KKP</b>
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Dardan Fusha <i>Zëvendësguvernator për Operacionet Bankare</i>	Kryesues
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Lumni Rrustolli <i>Drejtor i departamentit të infrastrukturës së tregut dhe pagesave</i>	Zv. Kryesues
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Blerim Terziqi <i>Drejtor i departamentit të Mbikëqyrjes bankare</i>	Anëtar
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Elvin Mala <i>Udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të Informacionit</i>	Anëtar
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Amir Zylfiu <i>Shef i kabinetit të Guvernatorit</i>	Anëtar
<b>Thesari i Kosovës/MFPT</b>	Z. Nysret Koca <i>Zv. Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar
<b>Shoqata e Bankave të Kosovës</b>	Z. Petrit Balija <i>Drejtori Ekzekutiv i SHBK</i>	Anëtar
<b>Shoqata e Bankave të Kosovës</b>	Znj. Akile Cernobregu-Hashani <i>Kryesuese e komitetit të pagesave</i>	Anëtare
<b><sup>1</sup>IFJB-Institucionet e Pagesave</b>	Znj. Eda Shaqiri	Anëtare
<b>IFJB-Institucionet e parasë Elektronike</b>	Z. Atdhetar Ibrahim	Anëtar
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Znj. Valmira Halili <i>Sekretare e KKP-së</i>	Anëtare

<sup>1</sup> Anëtarët e KKP-së, përfaqësues nga Institucionet Financiare Jo-Bankare, janë anëtarë të caktuar për përfaqësim në këtë takim. IFJB-të duhet të caktojnë dhe informojnë BQK për anëtarët me të drejtë vote, për takimet e ardhshme në pajtim me Udhëzimin për KKP.

<b>Shoqata e Bankave të Kosovës</b>	Znj. Blendina Llabjani <i>Sekretare e KKP-së</i>	Anëtare
<b>Pjesëmarrësit te tjerë</b>		
<b>ATK</b>	Z. Sami Salihu	Pjesëmarrës
<b>AMIK</b>	Z. Shpresim Vranoci	Pjesëmarrës
<b>IFC</b>	Z. Suad Lushtaku	Pjesëmarrës
<b>Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë</b>	Z. Besnik Vasolli	Pjesëmarrës
<b>ASHI</b>	Z. Genc Hamzaj	Pjesëmarrës
<b>EIC</b>	Z. Emrush Ujkani	Pjesëmarrës
<b>Zyra e BE-së në Kosovë</b>	Znj. Feride Zeka	Pjesëmarrës
<b>Banka Botërore</b>	Z. Peter Jensen	Pjesëmarrës
<b>Bankat Komerciale</b>	Z. Visar Paçarada – PCB Z. Dukagjin Shulemaja – TEB Z. Gazmend Rustemi – BpB Z. Shpend Luzha – BE Z. Valdrin Islami – RBKO Z. Gem Maloku - NLB Z. Fatlinda Xhigoli – Ziraat Z. Fisnik Behxheti – Pribank Z. Shpend Nura - Credins	Pjesëmarrës
<b>IFJB</b>	Z. Nora Rraci – Posta e Kosovës Z. Gazmend Selmani- IBAS Z. Remzi Hashani – Moneta Z. Nusret Hasni – Capital Z. Astrit Sallauka – Vllesa Co (Ria) Z. Arben Feri – Finser Z. Armend Kumnova – Paysera Z. Arsim Bruçaj – Velanis/Swinto Z. Yll Dushi – Onefor Kosovo	Pjesëmarrës
<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>	Z. Ramadan Matarova Z. Ilir Hasani Z. Ibrahim Krasniqi Z. Sokol Shasivari	Pjesëmarrës

	Z. Arzen Caverbasha Znj. Vlora Mehanja	